



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/94

Datë: 19.03.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, si dhe në pajtim me nenin 7 të Ligjit Nr. 05/L-054 për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore Pranë Dhomave të Specializuara, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 mars 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë 40,000 (katër dhjetë mijë) euro për përkrahje financiare për z. Lahi Brahimaj i akuzuar potencial në procesin gjyqësor pranë Dhomave të Specializuara.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezerva Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232-13100 nga kategoria e shpenzimeve të rezervës.
3. Mjetet nga pika 1 e këtij vendimi transferohen në Ministrinë e Drejtësisë me kod 215, nën programi Mbrojtja Juridike dhe Mbështetja Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore Pranë Dhomave të Specializuara me kod 37900, kategoria e shpenzimeve të subvencionet dhe transferet.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

For
 Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë